



Nr. 2322/Prot.,
3

Tiranë, më 20.09.2024

VENDIM

Nr. 39, datë 20.09.2024

PËR

**“MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027 DHE
TREGUESVE TË BUXHETIT TË VITIT 2025, PËR
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Bazuar në Ligjin nr.80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2018 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në Ligjin nr.10296, 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; në Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, në Udhëzimin Plotësues nr.4, datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027”, në Rregulloren e Brendshme, të ndryshuar, “Për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, në Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Vendimin e Rektoratit dhe GMS-së nr.03, datë 05.08.2024 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe treguesit e vitit 2025, për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”; Vendimin e Senatit Akademik nr.110, datë 13.09.2024 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe treguesit e vitit 2025, për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, pasi mori në shqyrtim relacionin e grupit EMP të dërguar me shkresën e Administratorit të UMT-së nr.1346/31 prot., datë 16.09.2024 “Dërgohen për miratim treguesit e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”, Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në mbledhjen e datës 20.09.2024,

VENDOSI:

1. Të miratoj Programin Buxhetor Afatmesëm për vitet 2025-2027, të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, sipas tabelave bashkëlidhur këtij vendimi, Aneksi 7A.
2. Të miratoj treguesit e buxhetit të vitit 2024 të parashikuar në PBA 2025-2027. Rishikimi i tyre do të kryhet me ardhjen e grantit buxhetor dhe rakordimin e të ardhurave të trashëgueshme.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
ZAMIRA GJINI**

ANËTARË

MONIKA FIDA

VERA OSTRENI

ALTINA XHAFERI

ANIS THODHORJANI

ALBANA GJINOPULLI

ENDRIT YZEIRAJ